VENDIM
Nr. 588, datë 7.9.2022

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "SISTEMIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE DHE PARKIM, LAGJJA E RE, BLLOKU PAS ISH-BASHKISË PATOS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Sistemimi i hapësirave publike dhe parkim, lagjja e re, blloku pas ish-Bashkisë Patos".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Patos.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 3 490 235.1 (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë pikë një) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 490 235.1 (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë pikë një) lekësh, përballohet nga Bashkia Patos.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Patos.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Patos.
8. Bashkia Patos kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Patos.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Patos për pasuritë e shpronësuara.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Patos.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Patos, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN NGA PROJEKTI
"SISTEMIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE DHE PARKIM, LAGJJA E RE, BLLOKU PAS ISH-BASHKISË PATOS"

Nr.	TË DHËNAT PËR PRONARIN												Gjendja juridike
	Emri i pronarit	Z.K.	Nr. pas.	Sip. totale e truallit (m^2)	Sip. e prekur e truallit (m^2)	Çmimi i truallit (lekë/m^2)	Vlera e truallit (lekë/m^2)	Funksioni i godinës	Sip. e ndërtesës (m^2)	Sip. e prekur e ndërtesës (m^2)	Vlera e ndërtesës (lekë)	Vlera totale (lekë)	
1	Arben Uka	2890	8/57	80	80	2848	227,840.00	shërbim	80	80	1,599,152.10	1,826,992.10	Vërtetim hipotekor
2	Andi Bregasi	2890	8/67+1-1	0	0	2848	-	apartament	63.8	63.8	,498,059.00	1,498,059.00	Vërtetim hipotekor
3	Jemine Mucaj	2890	8/23-N1	58	58	2848	165,184.00	-	0	0	0	165,184.00	Vërtetim hipotekor
Vlera totale												**3,490,235.10**	

Vlerësimi për pasuritë e llojit "Truall" është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".
Vlerësimi i objektit "Godinë" është bërë në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar.